



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së shtatë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 18.7.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Nenad Miladinovic, Elmira Nikçi Rexha, Oktay Kurtesh, Tiera Kasumi Berisha, Adnan Ajeti, Kimeta Shok.

Munguan: Arton Brahim, Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Fisnik Dida - përfaqësues nga OSCE-ja, Diellza Mustafa - OSCE, Maciej Socha - përfaqësues nga EULEX-i, Mateviz Markowicz - EULEX, Arianita Beqa Rraci - UNMIK, Klaudia Mula - zyrtare për komunitete në ZKKK, Fatlinda Hoxha - zyrtare nga Drejtoria e Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Izet Sadiku - drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë në Komunën e Prishtinës, Diyana Renda - EU.SR, Pleurat Murati - EU.SR.

Mbledhjen e hapë dhe e kryesoi kryesuesja e Komitetit për Komunitete znj. Mirsada Behluli me këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit e Komitetit për Komunitete;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete;
3. Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave brenda gjashtë muajve;
4. Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku që të na njoftoj lidhur me:
 - a) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për anëtarët e komuniteteve joshumicë;
 - b) Zbatimi i programit të vaksinimit për fëmijët e komunitetit ashkali dhe rom;
5. Raporti i ZKKK-ës, për muajin qershor 2025;
6. Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë mbi situatën në komunitetin e tyre;
7. Të ndryshme.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga seanca e fundit e Komitetit për Komunitete

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Pika e dytë

Shqyrtimi dhe miratimi i raportit gjashtëmuor i punës së Komitetit për Komunitete

Mirsada Behluli - lidhur me raportin gjashtëmuor të punës së Komitetit për Komunitete tha besoj se raportin e keni lexuar, prandaj ju kisha lutur a ka dikush ndonjë vërejtje, sugjerim apo të shtojë diçka në raport.

Nenad Miladinovic – sa i përket raportit të punës gjashtëmuore tha se është i gjerë dhe vërtet janë përfshirë të gjitha aktivitetet tona të bëra gjatë kësaj periudhe ku lirisht mund të them se mundet të jetë edhe raport vjetor, pasi që takimi i fundit i Komitetit do të jetë diku pas zgjedhjeve.

Mirsada Behluli – tha se raporti është gjithëpërfshirës, i argumentuar dhe është thënë ti jepet prioritet me atë që kemi punuar dhe me kendo jemi takuar.
Pra është cekur vizita nëpër shkolla e shumë të tjera.

Klaudia Mula – duke u ndërlidhur në diskutim tha se fillimisht mendoj se duhet të caktojmë një takim me drejtoreshën e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale dhe të shohim se sa kanë buxhet dhe sa familje mund t'i i mbështesin. Pra mos të bëjmë lista koti e pastaj të kemi ankesa dhe vërejtje të qytetarëve. Andaj mundemi së bashku të caktojmë një takim dhe t'i shtrojmë këto çështje.

Adnan Ajeti – tha se dy familje nga komuniteti rom nuk kanë mundur me ardh me i marr drunjtë e zjarrit pasi që nuk patën transport, prandaj shtroi pyetje se a ka mundësi që t'ju dilet në ndihmë.

Pika e tretë

Shqyrtimi i kërkesave dhe ankesave brenda gjashtë muajve

Mirsada Behluli – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se gjatë këtyre gjashtë muajve çdonjëri nga ju keni paraqitur ndonjë kërkesë apo ankesë, prandaj kisha me ju drejtuar Klaudies që të na informojë se gjatë këtyre gjashtë muajve a ka pasur ndonjë ankesë apo kërkesë dhe a janë zgjidhur ato dhe a kanë marrë përgjigje me kohë.

Klaudia Mula – duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne në çdo takim i raportojmë Komitetit për çdolloj ankese apo kërkesë që kanë pasur komunitetet. Pra nuk ka diçka që mundet me u cek, ato çka kemi pasur mundësi jemi munduar dhe i kemi zgjidhur.

Kimeta Shok – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës tha se nga komuniteti goran nuk ka pasur ankesa vetëm se muajin e kaluar ka pasur kërkesa për ndihmë financiare për sëmundje të kancerit.

Pika e katërt

Ftesë për drejtorin e Drejtorisë së Shëndetësisë z. Izet Sadiku që të na njoftoj lidhur me:

Faqe 2 nga 4

- a) Ofrimi i shërbimeve shëndetësore për anëtarët e komuniteteve joshumicë;
b) Zbatimi i programit të vaksinimit për fëmijët e komuniteteve ashkali dhe rom;

Fatlinda Hoxha – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se Drejtoria e Shëndetësisë për të gjithë personat pa dallim race, gjinie, moshe ofron shërbime shëndetësore për banorët e kryeqytetit. Ajo mes tjerash tha se më datë 29.5.2025 në Qendrën e Mjekësisë Familjare – I- është mbajtur takim me qytetarët e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian d.m.th në kuadër të aktiviteteve të vetëdijes së qytetarëve, kanë mbajtur ligjeratë vetëdijësuese edukativo-shëndetësore, rreth planifikimit familjar dhe në atë rast janë shpërndarë materiale edukativo-shëndetësore. Ndërsa më datë 6.3.2025 është organizuar një ekip mobil për vaksinimin e fëmijëve të të gjitha komuniteteve duke e përfshirë edhe komunitetin RAE, në ç'rast është bërë edhe kontrollimi i fëmijëve, imunizimi i fëmijëve të pavaksinuar d.m.th janë vaksinuar, si dhe është bërë shpërndarja e materialit informues lidhur me rëndësinë e vaksinimit, me parandalimin dhe mbrojtjen nga sëmundjet infektuese. Gjithashtu më dt. 8.4.2025 është mbajtur ligjeratë për rëndësinë e vaksinimit, parandalimit dhe mbrojtjes nga sëmundjet infektive në Shkollën e mesme të ulët “Asim Vokshi” ku në këtë rast është bërë edhe shpërndarja e materialit. Këtu janë disa aktivitete të shënuara, përndryshe të gjitha profilet shëndetësore në vazhdimësi ngrisin vetëdijen edhe për planifikimin familiar edhe për vaksinim, edhe njoftohen me ditët e shëndetësisë siç janë ditët e tensionit, diabetit dhe të gjitha sistemeve të organeve të ndryshme. Pra kjo do të ishte një përmbledhje e shkurtë për gjashtëmujorin e parë.

Klaudia Mula – duke u ndërlidhur në diskutimin e znj. Hoxha tha se ZKKK e monitoron në vazhdimësi caktimin e aktiviteteve që janë të parapara me Planin Lokal të Veprimit për komunitetet rom, ashkali egjiptian. Ajo në vazhdimësi tha se Drejtoria e Shëndetësisë vitin e kaluar pothuajse 90 % ka arritur me intervenuar, si dhe mund të them se kemi një bashkëpunim shumë të mirë ku për këtë e falënderoj shumë kolegen në fjalë.

Nenad Miladinovic - duke u ndërlidhur në diskutim tha se pajtohem me Klaudien, meqë që 12 vite jam i kyçur në këto punë ku dhe shfrytëzoj rastin të falënderoj znj. doktoreshë për bashkëpunim të mirë. Ai në vazhdimësi tha se pa marrë parasysh se çka kemi pasur ankesa apo kërkesa gjithmonë është munduar të na ndihmojë apo të drejtojë në adresë të saktë. Pra me të vërtetë e falënderoj si dhe vërtetë nuk ka vërejtje kur është në pyetje shërbimi shëndetësor.

Fatlinda Hoxha - duke iu falënderuar diskutuesve për fjalët miradie tha se Drejtoria e Shëndetësisë nuk mund të them se ka ndonjë dallim nga drejtoritë tjera, por na mbron ligji që është ofrimi në shërbimin shëndetësor pa dallim race, gjinie, moshe dhe vazhdojmë të jemi të përqendruar t'i ofrojmë shërbime shëndetësore të gjithë qytetarëve, ndërsa në anën tjetër edhe për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore. Unë po shpresoj dhe po besoj që edhe me kolegun e edhe me Klaudien kemi me pasur bashkëpunim të mëtutjeshëm, dhe se ky 10 %-i mosardhjes së pjesëtarëve do të bie në 1%.

Adnan Ajeti – tha se komuniteti rom është i kënaqur me ofrimin e shërbimeve shëndetësore.

Izet Sadiku – duke iu falënderuar për ftesën tha se meqë doktoresha ju ka dhënë sqarime lidhur me punën e drejtorisë sonë, unë desha edhe njëherë të shprehi vullnetin për bashkëpunimin tonë me Komitetin për Komunitete. Pra të përfshihen sa më shumë edhe komunitetet joshumicë në projektet tona, pasi që sëmundja nuk zgjedh as gjini, as etnitet.

Pika e pestë

Raporti i ZKKK-ës, për muajin qershor 2025

Page 3 nga 4

Klaudia Mula – sa i përket kësaj pike të rendit të ditës në pika të shkurta i informoi të pranishmit lidhur me punën dhe aktivitetin e ZKKK-ës. Njëzëri u miratua Raporti i ZKKK-ës për muajin qershor 2025.

Pika e gjashtë

Raportimi i përfaqësuesve të komuniteteve joshumicë mbi situatën në komunitetin e tyre

Nenad Miladinovic - sa përket sigurisë tha se që nga takimi i kaluar nuk kemi pasur ndonjë problem, ndërsa sa i përket problemit të infrastrukturës ai mbetet i njëjtë pasi që nuk është punuar asgjë. Ai në vazhdim tha se si përfaqësues i komunitetit serb me kërkesë të këshillit të shkollës dhe drejtorit të Shkollës fillore të ulët “Dimitrije Prica” në Bardhosh kam për obligim të kërkojë sqarim nga organet kompetente të Komunës së Prishtinës, lidhur me zhvillimin e disa punimeve në parcelën ku gjendet shkolla, pra më intereson të di se a kanë dhënë lejen për zhvillimin e punimeve dhe se a janë respektuar procedurat ligjore dhe pronësore. Pra zhvillimi i këtyre punimeve ka ndodhur më 29.6.2025, ku sipas disa informatave që kam investitor është Qeveria e Kosovës dhe në pyetje është ndërtimi i çerdhes ku plotësisht e përkrahi ndërtimin e çerdhes, terreneve sportive.

Pika e shtatë

Të ndryshme

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Takimi i radhës do të mbahet më 11.9.2025

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli



Faqe 4 nga 4